



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 457 Prot.

Tiranë, më 28.03 2019

VENDIM Nr. 83 datë 18.03.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"* Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 3, datë 18.03.2019, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Zgërdheshi: Transformimi i një qyteti ilir gjatë antikitetit të vonë dhe mesjetës" 2019*, drejtuar nga Dr. Elvana Metalla (IA), dhe Dr. Thomas Maurer (Universiteti Goethe Frankfurt-Gjermani), miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Zgërdheshi: Transformimi i një qyteti ilir gjatë antikitetit të vonë dhe mesjetës" 2019*, drejtuar nga Dr. Elvana Metalla (IA), dhe Dr. Thomas Maurer (Universiteti Goethe Frankfurt-Gjermani), miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Pastrime dhe sondazhe në Kishën mesjetare si dhe plotësim me dokumentacionin shkencor;
 - Pastrime dhe sondazhe në portën jugore;
 - Pastrim nga bimësia e Akropolit me qëllim plotësimin me dokumentacion shkencor bashkëkohor.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2019.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO**